

**UDHËZIME PËR
RAPORTIM TË SIGURT
DHE PROFESIONAL
MBI KORONAVIRUSIN
(COVID-19)**



Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Mars, viti 2020, Shkup

Autorë:

Dr. Marina Tuneva,

*Drejtoare ekzekutive e Këshillit
për Etikë në Mediat në Maqedoni*

Ognen Janeski,

*gazetar dhe alumni-hulumtues
në Departamentin e KB-së për
Informim Publik në Nju Jork,
SHBA*

Botues:

**Shoqata e Gazetarëve të
Maqedonisë**

Adresa: Gradski xid, blloku 13, 1000
Shkup, Republika e Maqedonisë së
Veriut

Tel: 00389 (02) 3298-139, e-mail:
contact@znm.org.mk

Në bashkëpunim me:

**Këshillin për Etikë në Mediat në
Maqedoni (KEMM)**

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Pjesa A [Dr. Marina Tuneva]	5
Udhëzime për raportim etik, profesional dhe përgjegjës mbi koronavirusin	5
o Kontroll i mirë i informacioneve	5
o Kontinuiteti në informim	7
o Qetësimi i tensioneve dhe oferta e zgjidhjes	7
o Shfrytëzimi i burimeve adekuate të informacioneve	8
o Përdorimi i titujve adekuatë	9
o Të shfrytëzohen sqarime të zakonshme	10
o Përdorimi i fjalorit të duhur, pa sensacion	10
o Vendosja e storjeve në kontekstin e duhur	11
o Përdorimi i kujdesshëm i vizualizimit	11
o Roli aktiv në zbulimin e dezinformatave	12
Pjesa B [Ognen Janeski]	14
Protokolli për mbrojtje dhe vetëmbrojtje të gazetarëve dhe punonjësve të mediave gjatë pandemisë nga COVID -19 (koronavirusit)	14
o Masat standarde për përkujdesje	15
o Rekomandimet për raportim nga terreni	17
o Rekomandime për punë redaktuese	20
o Pjesëmarrja e personave nga jashtë në emisione	24
o Siguria online gjatë kohës krizës	25
o Këshilla për marrëdhënien e punës	25

Raportimi mbi koronavirusin, nga këndvështrimi etik, është një detyrë mjaft e ndërlikuar pasi mediat përballen me dy përgjegjësi kryesore: të thonë të vërtetën dhe të mos shkaktjnë frikë të panevojshme dhe shqetësim tek publiku.

Duke pasur parasysh faktin se ka shumë informacione në dispozicion, si nga burimet tradicionale (media, institucionet shëndetësore), ashtu edhe nga burimet e reja (blogjet, rrjetet sociale), bëhet gjithnjë e më e qartë se sa e vështirë është detyra e mediave për të raportuar për këtë paraqitje.

Vërshimi gjithnjë më i madh i informacioneve në lidhje me COVID-19 (sëmundje e shkaktuar nga koronavirusi) është një sfidë si për gazetarët, ashtu edhe për profesionistët me të cilët bisedojnë ata në kërkim të informacioneve. Ata duhet doemos të bëjnë dallimin midis burimeve të ligjshme dhe të besueshme të informacioneve nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, spekulimeve, gjysmë të vërtetave dhe informacionet propaganduese.

Në rrjetet sociale dhe në Internet hasen përmbajtje të shumta që mund të provokojnë reagime të forta emocionale, siç janë paniku ose frika, ndërsa disa media publikojnë informacione të tilla pakkontrolluara nëse janë të vërteta apo të mendojnë për pasojat nga publikimi i tyre.

Përhapja e COVID - 19 është shkak për shqetësimin e madh të publikut, por raportimi në disa media ka kontribuar në rritjen e shqetësimit në një mënyrë që nuk ka arsye etike. Përhapja e dezinformatave gjatë një epidemie ose një pandemie të sëmundjeve mund të ketë pasoja serioze, ndërsa ulja e sasisë së vëllimit të këshillave dhe rekomandimeve të dëmshme mund të zvogëlojë atë efekt.

Këshilli për Etikë në Mediave të Maqedoni (KEMM) dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (ShGM) u kanë bërë thirrje mediave të sillen në mënyrë profesionale dhe etike dhe të mos kontribuojnë në përhapjen e gënjeshtreve dhe krijimin e panikut në opinion. Udhëzimet për raportim profesional, përgjegjës dhe etik mbi

koronavirusin janë përgatitur në kuadër të përpjekjeve për të nxitur rolin e rëndësishëm të mediave për të kuptuar si duhet shfaqja e koronavirusit, pasojat e tij dhe mënyrat e parandalimit efektiv.

Udhëzimet bazohen në rekomandimet e organizatave ndërkombëtare, siç janë: Poynter, First Draft, Journalist's Resource, Open Notebook, Reframe, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), gazetarë me përvojë, shkencëtarë dhe ekspertë.

Më tej, qëllimi i këtyre udhëzimeve është të ofrojnë edhe informacione themelore për mbrojtjen e gazetarëve dhe punonjësve të mediave gjatë kryerjes së detyrave të tyre të punës në terren, në redaksi dhe nëpër studio.

Gazetarët dhe punonjësit e mediave janë të ekspozuar ndaj rreziqeve gjatë punës së tyre në terren, në redaksi dhe në studiot e tyre të raportimit televiziv dhe nëpër radio. Rreziqet e tilla, në mes të një pandemie të shpallur zyrtarisht nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, janë në rritje e sipër.

Këto udhëzime duhet t'i orientojnë gazetarët dhe punonjësit e mediave, para së gjithash, të vetëmbrohen, por edhe t'i mbrojnë të tjerët përreth tyre, gjatë kryerjes së detyrave të tyre të punës.

Mediat, përveç që ofrojnë raportim etik për situatën me pandeminë e koronavirusit, e edukojnë gjithashtu publikun përmes vetëdijes së tyre dhe gjatë kësaj janë pjesë e zgjidhjes për ballafaqim me krizën.

од авторите

KONTROLL I MIRË I INFORMACIONEVE

Informacionet e rreme dhe të pasakta përhapen me shpejtësi të madhe, dhe njerëzit shpesh i ndajnë ato pa ndonjë verifikim. Një grup shkencëtarësh nga Universiteti i Teknologjisë në Massachusetts në vitin 2018 arritën në përfundimin se storjet që shkaktojnë një përgjigje emocionale më shumë shpërndahen se sa përmbajtjet e tjera¹. Edhe neurologët konfirmojnë se ne kemi më shumë të ngjarë të mbajmë mend histori që na bëjnë të zemëruar, të trishtuar ose të tallur². Për këto arsye, është veçanërisht e rëndësishme të kontrollohet burimi i informacionit përpara se të shkruhet një përmbajtje gazetareske. “Megjithëse media të tjera raportojnë për një storje të caktuar, kjo nuk do të thotë se burimi i informacionit është verifikuar me besueshmëri”³.

Një pjesë e përgjegjësive të gazetarëve është të zbulojnë origjinën e informacioneve. Kjo shpesh nënkuptohet që figura publike, funksionarë, ministra dhe burime të tjera ose bashkëbiseduesve t’u parashtrojnë pyetje në lidhje me origjinën e informacionit që ata japin. Në kushte të shqetësimit të gjerë publik, nga pushteti, figurat publike dhe bashkëbiseduesit që i plasojnë informacionet në media pritet t’u përmbahen standardeve të larta të përgjegjshmërisë.

Edhe përpos faktit që një përmbajtje e caktuar është e ilustruar me tabelë apo grafik, kjo nuk do të thotë se shifrat janë të sakta dhe argumentet e qëndrueshme. Problemi me “shkencën e shpejtë”, siç nënvizon Rojters, është që

¹ Vosoughi, S., Roy, D., Aral S. „*The spread of true and false news online*”, Science 09 Mar 2018: Vol. 359, Issue 6380, pp. 1146-1151 DOI: 10.1126/science.aap9559

² Anne Barr, R. (2019) *Galaxy brain: the neuroscience of how fake news grabs our attention, produces false memories, and appeals to our emotions*, Nieman Lab, qasje në: <https://www.niemanlab.org/about/>

³ First Draft (2020) *Tips for reporting on Covid – 19 and slowing the spread of misinformation*, qasje në: <https://firstdraftnews.org/latest/tips-for-reporting-on-covid-19-coronavirus-and-slowing-the-spread-of-misinformation/>

njerëzit fillojnë të bëjnë panik ose të marrin vendime të gabuara para se t'i humtojnë të dhënat siç duhet.

Ja disa rekomandime:

- Të përcaktohet burimi dhe nga rrjedhin informacionet.
- Të konsultohet burimet oficiale të informacioneve, si, për shembull, nga ueb faqja e OBSH-së që ka të bëjë me koronavirusin (<https://www.who.int/health-topics/coronavirus>).

MOS LEJONI T'JU MASHTROJNË DEZINFORMATAT ONLINE

Kontrolloni këto çështje kur kërkoni nëpër rrjetet sociale

Burimi – mendoni dhe shqyrtoni se çfarë qëndron në prapaskenë. Kontrolloni origjinën e ueb faqes ose profilin e rrjetit social, kontrolloni të dhënat themelore, emrat dhe mbiemrat

Historia – nëse burimi ka ndonjë agjendë? Zbuloni se çfarë lloj të temave zakonisht trajton dhe nëse promovon vetëm një perspektivë

Prova – studioni detalet të ndonjë konfirmimi dhe shihni nëse është mbështetur me dëshmi të besueshme

Emocionet – nëse burimi bazohet në ndonjë emocion për të veçuar një poentë? Kontrolloni nëse ka retorikë sensacionale, ndezëse ose ndarëse

Fotografite – fotografite vlejné sa një mijë fjalë. Kontrolloni se çfarë mesazhi ilustron ose përcjellë fotografia dhe nëse burimi shfrytëzon fotografi për të tërhequr vëmendje

Burimi: First Draft

KONTINUITETI NË INFORMIM

Është e rëndësishme që mediat të ruajnë kontinuitetin në informim mbi COVID-19 jo vetëm për publikun që i ndjek, por edhe për publikun që më parë nuk i ka kushtuar shumë vëmendje problemit.

Kjo do të thotë që do të ketë nevojë për raportim në atë mënyrë që do t'i informojë edhe ata që nuk janë të informuar sa duhet, duke siguruar kontekstin e duhur dhe informacionet e nevojshme, madje edhe nëse përsëriten të njëjtat përmbajtje.

QETËSIMI I TENSIONEVE DHE OFERTA E ZGJIDHJES

Në kushte të brengosjes dhe shqetësimit të madh për përhapjen e virusit dhe pasojat e tij, mediat duhet t'u ndihmojnë qytetarëve me informacione konkrete në lidhje me mbrojtjen dhe masat që duhet t'i ndërmarrin. Rekomandimet duhet të bazohen në burime relevante dhe zyrtare, siç është Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe institucionet shëndetësore dhe përfaqësuesit zyrtarë, me një verifikim të mirë të besueshmërisë së informacioneve që i plasojnë.

Njohja e frikës dhe pasiguria mund të ndihmojnë në tejkalimin e tyre. Raportimi duhet të pasqyrojë shqetësimet e publikut, por gjithashtu duhet të orientohet edhe në sigurimin e informacioneve të sigurta rreth asaj si duhet të veprojnë. Në të njëjtën kohë, mediat, duke njohur nevojën për përgjigje të pyetjeve që i kanë qytetarët, duhet të theksojnë se për disa prej pyetjeve të tyre ende nuk ka përgjigje dhe se po punojnë për të gjetur një zgjidhje për problemin, nëse vërtetë është kështu.

SHFRYTËZIMI I BURIMEVE ADEKUATE TË INFORMACIONEVE

Mediat duhet ta bazojnë raportimin e tyre të informacioneve në më shumë se një burim. Ekspertët e ndryshëm kanë perspektiva dhe informacione të ndryshme që mund të jenë të dobishme për t'u parë pasqyra e qartë për rrethanat dhe konteksti i problemit.

“Kërkoni ekspertë të sëmundjeve infektive dhe ekspertë të shëndetit publik për të marrë informacione të argumentuara dhe përgatituni se do të hasni në njerëz që janë duke u përpjekur ta prezantojnë veten si ekspertë, që në fakt nuk janë”⁴. Ndodh që disa politikanë ose figura publike t'i prezantojnë dëmet dhe rreziqet si më të vogla, disa jo-profesionistë përpiqen të imponojnë terapi dhe mënyra të papërshtatshme të mbrojtjes etj. Në përpjekje për të marrë informacione sa më të shpejta, gazetarët ndonjëherë u parashtrojnë pyetje personave që nuk kanë njohuri mbi këtë temë për të dhënë sqarim dhe mendim adekuat. Bill Henixh, profesor i Epidemiologjisë në Shkollën e Shëndetit Publik në Harvard, rekomandon që gazetarët të gjejnë studiues ose profesionistë me njohuri dhe përvojë në lidhje mbi temën, dhe nëse ata u theksojnë se u mungojnë njohuri konkrete, këtë duhet ta transmetojnë. “Duke raportuar mbi pandeminë, është me rëndësi që gazetarët të sqarojnë se çfarë dinë ekspertët dhe çfarë mendojnë se dinë, në bazë të përvojave të tyre dhe vlerësimit të dëshmive”⁵.

Mediat, po ashtu, duhet të shmangin “balancën e rrejshme” në përzgjedhjen e bashkëbiseduesve dhe nuk duhet të lejojnë të shfrytëzohen deklaratat nga bashkëbiseduesit që nuk janë relevante dhe të cilat nuk kanë informacione të rëndësishme për opinionin.

⁴ Open Notebook (2020) *Tip sheet: Covering the coronavirus epidemic effectively without spreading misinformation*, qasje në: <https://www.theopennotebook.com/2020/03/02/tipsheet-covering-the-coronavirus-epidemic-effectively-without-spreading-misinformation/>

⁵ Journalist's Resource, *Covering COVID-19 and the coronavirus: 5 tips from a Harvard epidemiology professor*, 06.03.2020, qasje në: <https://journalistsresource.org/studies/society/public-health/covid-19-coronavirus-epidemiology/>

Gazetarët, zakonisht, citojnë mjekë, edhe pse jo rrallëherë dhe stafin tjetër jo mjekësor, si për shembull, infermierë, mund të ofrojnë informacione relevante dhe të dobishme, duke u thirrur në përvojën e tyre, sidomos kur bëhet fjalë për kontrollin e sëmundjeve infektive.

PËRDORIMI I TITUJVE ADEKUATË

Gjatë pandemisë, kur informacionet përhapen me shpejtësi, nuk lejohet që të bëhen tituj që e orientojnë vëmendjen e pjesës tjetër të storjes. “Në kushte të këtilla, doemos duhet të merret në konsideratë se lexuesi mesatar e përjeton raportimin tuaj vetëm përmes titullit”⁶.

Edhe pse teksti gazetaresk mund të përmbajë shpjegime të kujdesshme dhe precize, megjithatë, është akoma shumë e rëndësishme se si do të vendosen titujt, pasi publiku, jo rrallëherë vetëm i kalon nëpër to dhe nuk e lexon pjesën tjetër.

Në të njëjtën kohë, rekomandohet që redaksitë e lajmeve t’i përshtatin titujt për platforma të ndryshme, duke dalluar titujt që publiku i lexon në rrjetet sociale dhe titujt që shfaqen kur qytetarët kërkojnë informacione në motorët e kërkimit në internet.

⁶ Reframe, *Reframe: Reporting on coronavirus*, qasje në: <https://reframe.resolvephilly.org/covid-19/>

TË SHFRYTËZOHEN SQARIME TË ZAKONSHME

Mediumet duhet t'i transmetojnë informacionet thjeshtë dhe qartë, përmes ilustrimit të poentave kryesore. Rekomandohet që ata të fokusohen në fakte në mënyrë të thjeshtë, që të tërhiqet vëmendja e publikut dhe të propozojnë hapa dhe masa konkrete.

PËRDORIMI I FJALORIT TË DUHUR, PA SENSACION

Fjalori i përdorur në raportimin është shumë i rëndësishëm dhe ai duhet të korrespondojë me ngjarjet dhe rrethanat reale

Në raportimin gazetaresk, shpesh përdoren fjalë të tilla si “virusi vdekjeprurës”, “vrasësi”, “katastrofa”, “tmerri”. Fjalë të tilla tërheqin më shumë klikime, por gjithashtu mund të shkaktojnë panik, që është në kundërshtim me atë që rekomandojnë epidemiologët, virologët, autoritetet shëndetësore etj.

Prandaj, rekomandimi është që sa më e keqe të jetë situata, aq më shumë gazetarë t'i kufizojnë mbiemrat subjektivë dhe t'u përmbahen fakteve të forta. Publiku është i vetëdijshëm se situata është serioze.

“Gazetarët duhet të bëjnë dallimin midis natyrës së kërcënimit dhe përgjegjësisë për të menaxhuar emocionet e publikut dhe të mos përhapin frikë të tepruar”, thotë profesoresha Karin Val Jorgensen nga Universiteti i Kardifit.

Gazetarët, po ashtu, duhet të shmangin përdorimin e citateve nga bashkëbiseduesit që shpijnë në spekulime, sensacion apo thashetheme.

VENDOSJA E STORJEVE NË KONTEKSTIN E DUHUR

“Çdoherë kur duhet, mediat duhet t’u ndihmojë qytetarëve të kuptojnë se si funksionon sistemi shëndetësor dhe shkenca, si funksionon sistemi imunitar dhe si transmetohen dhe ndikojnë viruset”⁷. Është e rëndësishme që mediat të shmangin informimin vetëm “si servis”, pa e shpjeguar kontekstin e vërtetë. “Storjet që u shpjegojnë njerëzve mënyrat e parandalimit dhe përhapjes së virusit janë më pak të frikshme se sa ato që nuk përmbajnë informacion të tillë”⁸.

Gazetarët duhet të potencojnë se koronavirusi, për shumicën e njerëzve, nuk është vdekjeprurës. Sipas OBSH, ky është virusi i ri ndaj të cilit askush nuk është imun, që do të thotë se më shumë njerëz janë të ndjeshëm ndaj infeksionit, ndërsa në nivel global rreth 3.4% të rasteve të raportuara të kësaj sëmundje kanë vdekur⁹. Informacionet e këtij lloji, me interpretimin e duhur statistikor të të dhënave, duhet të përfshihen në raportimin e rregullt të mediatik dhe me këtë t’i mundësohet publikut të ketë një pasqyrë të qartë dhe të informohet në mënyrën e duhur.

PËRDORIMI I KUJDESSHËM I VIZUALIZIMIT

Një nga mënyrat më të shpeshta për përhapjen e dezinformative është përmes fotografive dhe videove që përdoren në kontekst të ndryshëm. Gjatë përdorimit të çfarëdo materiali nga ky lloj i publikimit, duhet saktë të prezantohet situata

⁷ Open Notebook (2020) *Tip sheet: Covering the coronavirus epidemic effectively without spreading misinformation*, qasje në: <https://www.theopennotebook.com/2020/03/02/tipsheet-covering-the-coronavirus-epidemic-effectively-without-spreading-misinformation/>

⁸ Ibid.

⁹ Organizata Botërore e Shëndetësisë, “WHO Director General’s opening remarks at the media briefing on COVID – 19”, qasje në: <https://www.who.int/dg/speeches/detail/who-director-general-s-opening-remarks-at-the-media-briefing-on-covid-19---3-march-2020>

në të cilën janë bërë, prejardhja e tyre, konteksti e kështu me radhë. Sidomos është e rëndësishme të shmanget përdorimi i fotografive/ilustrimeve gjenerike që nxisin akoma më shumë frikë dhe panik.

Ekzistojnë mekanizma online që mundësojnë të kontrollohet prejardhja dhe origjinaliteti i fotografive (si për shembull, Google image, RevEye's Plugin, Tin-Eye, Bing e kështu më radhë) dhe videove (InVid). Për t'u zbuluar se ku është bërë fotografia ose videoja, mund të shfrytëzohet edhe gjeolokacioni.

ROLI AKTIV NË ZBULIMIN E DEZINFORMATAVE

Pritet që mediat të luajnë rol aktiv në përhapjen e dezinformatave dhe informatave të rreme. Është e rëndësishme në këtë proces që informacionet e rrejshme të zëvendësohen me diçka që është e saktë. "Informoni menjëherë se bëhet fjalë për informacione të rreme, veçanërisht në titujt. Shpjegoni arsyet pse kjo gënjeshtër po përhapet, pse njerëzit e besojnë atë ose pse dikush po promovon gjëra të caktuara. Kështu do t'u ndihmohet njerëzve të kuptojnë pse po i ndjekin këto dezinformata edhe pse janë të gabuara. Shpjegimet e thjeshta dhe të shkurtër janë zakonisht më efikase"¹⁰.

Në gjithë këtë rol të rëndësishëm luajnë edhe udhëheqësit e programeve dhe emisioneve kontaktuese, prej të cilët pritet me kujdes t'i ndjekin deklaratat e personave që inkuadrohen, me qëllim që të shmanget transmetimi i dezinformatave në eter. Kjo, sidomos vlen për rrethanat kur personat e inkuadruar në program drejtpërdrejt paraqesin informacione të pa verifikuara nga rrjetet sociale, të publikuara në media tjera, e kështu me radhë.

¹⁰ Open Notebook (2020) *Tip sheet: Covering the coronavirus epidemic effectively without spreading misinformation*, qasje në: <https://www.theopennotebook.com/2020/03/02/tipsheet-covering-the-coronavirus-epidemic-effectively-without-spreading-misinformation/>.

Redaksitë duhet t'i kontrollojnë mirë faktet e prezantuara nëpër kolumna. Për shembull, në një kolumnë të publikuar kohë më parë në New York Post pohohet se koronavirusi është armë biologjike që ka dalë nga laboratorit kinez, pa asnjë dëshmi në kuptimin shkencor. Kolumna ishte një opinion “i paketuar” me gjuhën e shkencës dhe shkruar nga presidenti i Institutit të Hulumtimit të Popullsisë, një organizatë jofitimprurëse që e kundërshton kontrollin e popullatës¹¹.



¹⁰ Journalist's Resource, *Covering COVID-19 and the coronavirus: 5 tips from a Harvard epidemiology professor, qasje në: <https://journalistsresource.org/studies/society/public-health/covid-19-coronavirus-epidemiology/>*

Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për virus të sapo identifikuar, dhe burimi është i panjohur, ende ekzistojnë një numër i madh kufizimeve në lidhje me njohuritë e bartjes së tij. Nën disa kushte të caktuara, rruga ajrore e bartjes të disa koronavirusëve është vërejtur gjatë ekspozimit të pambrojtur në aerosolë të kontaminuar nga sekretet respiratorë ose me material fekalesh, që edhe në këtë rast të këtij koronavirusi, tani për tani nuk është përjashtuar si mundësi. Te njerëzit bartet në rrugë ajrore nëpërmjet sekreteve respiratore që lirohen gjatë kollitjes dhe/ose teshtimës. Koronaviruset zakonisht shkaktojnë sëmundje më të lehta të njerëzit e rritur, personat me sistem të çrregulluar imun dhe ata që jetojnë me sëmundje kronike (diabet, kancer dhe sëmundje kronike të mushkërive).

Gazetarët, punonjësit e medimeve, redaktorët përgjegjës, drejtuesit dhe ata që organizojnë takime me gazetarët ose gazetarët që organizojnë takime me burime të informacioneve sikurse për vete, ashtu edhe për kolegët, por edhe për opinionin publik kanë obligim t'u përmbahen rekomandimeve dhe udhëzimeve të dhëna nga institucionet e resorëve shtetërorë, siç janë Ministria e Shëndetësisë (MSH), Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), Qendrat rajonale për Shëndet Publik (QSHP), Komisioni për Shëndet Publik (KSHP), Ministria e Punëve të Brendshme, e Mbrojtjes dhe Punëve të Jashtme, Presidenti i Shtetit, si dhe institucione tjera shtetërore, por edhe organizatat dhe shoqatat e gazetarëve dhe punonjësve të medimeve të cilët rekomandimet e veta dhe informacionet i përcjellin nga organizatat ndërkombëtare, në bashkëpunim të ngushtë me OBSH-në.

MASAT STANDARDE PËR PËRKUJDESJE

1. Higjiena e duarve (larja e tërësishme dhe e rregullt e duarve).
2. Parimet themelore të higjienës së mirë respiratore janë:
 - teshtimë dhe kollitje në një shami të pastër ose faculetë për një përdorim,
 - hedhja e drejtë e shamisë/faculetës së përdorur në shportën e mbyllur të mbeturinave,
 - teshtimë dhe kollitje në krah në lartësi të pjesës së sipërme dhe/ose pjesës së lakut (lakut të mbledhur nga ana e brendshme) dhe assesi ajo të bëhet në shputë,
 - mbajtja e distancë nga së paku një metër mes jush dhe personave tjerë.
3. Mjete personale mbrojtëse adekuate me rrezikun e vlerësuar, posaçërisht në pjesën e përdorimit të pajisjes me të cilën punojnë punonjësit e mediave (dezinfektues për kamera, fotoaparate, mikrofona, sipërfaqeve punuese...), e me këtë edhe përdorim i sigurt, pastrim dhe dezinfektim i gjithë asaj që bie në kontakt me punonjësit e mediave .
4. Pastrimi i hapësirës punuese dhe rrethinës së jashtme.
5. Menaxhim adekuat i mbeturinave nga hapësirat punuese dhe jashtë tyre.
6. Përcaktimi i një personi të punësuar në medium, i cili do të jetë përgjegjës për komunikim dhe informim për situatën, derisa zgjat pandemia nga COVID-19.



- Menaxhmenti i medias ka obligim t'i lirojë nga obligimet e punës dhe t'i dërgojë në vetizolim ose të merret vesh me ata nëse dëshirojnë të punojnë nga shtëpia, gazetarët dhe punonjësit e medimeve që kanë ndonjë nga sëmundjet kronike nga diagnozat e shpallura në listën e Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Gazetarët më të moshuar dhe punonjësit e mediave, ata të cilët kanë gjendje shëndetësore kronike, e të cilët nuk janë pjesë e listës së MSH së RMV-së, si dhe gazetaret shtatzëna dhe punëtorët e mediave të cilat në mënyrë aktive shkojnë në punë në bazë të vendimit të tyre personal, përsëri janë pjesë e personave të cilët kanë rrezik të lartë të ekspozimit ndaj virusit dhe për këtë punëdhënësi duhet t'u japë obligime të cilat mund t'i kryejnë në kushte shtëpiake ose vetëm detyra redaktuese.
- Gjatë informimit nga vendet me grup më të madh të njerëzve, mbani distancë nga së paku tre deri pesë metra nga grupi, nëse ka nevojë t'i afroheni për incizim ose fotografim.
- Gjatë informimit nga ndonjë ngjarje, kërkoni informacion nga organizatori i ngjarjes vallë në hapësirën (nëse është e mbyllur) ka siguruar pjesë të veçantë për mediat dhe mundësi për distancë nga së paku një metër mes ekipeve gazetareske të secilit medium, posaçërisht mes kameramanëve, pa dallim nëse është takim ulur apo në këmbë.
- Gjithashtu, kërkoi mbrojtje nga përdorimi i një mikrofoni për parashtrimin e pyetjeve. Nëse këto protokolle nuk realizohen sipas standardeve, kërkoni nga organizatorët t'ju sigurojnë këtë ose t'ju japin qasje në transmetim të drejtpërdrejtë të ngjarjes (nëse kanë organizuar), prej ku do t'i siguronit deklaratat. Në të kundërtën, nëse duhet doemos të informoni nga një ngjarje e tillë, merrni vesh me kolegët vetë të radhiteni në ambient, ku do të keni distancë mes jush.

- Mund edhe të kërkoni nga personi për marrëdhënie me publikun dhe mediat, organizatorit të ngjarjes, se a mund t'i dërgoni pyetjet në rrugë elektronike dhe ato të parashtrihen ashtu siç janë shkruar drejt personit në interes të medimeve, e pastaj të merrni transkript të përgjigjeve dhe pyetjeve të parashtruara.
- Ekipet e gazetarëve dhe drejtuesit e mediave gjithashtu mund të bien dakord midis tyre të dërgojnë vetëm një ekip për të gjitha mediat, kur bëhet fjalë për ngjarje me interes publik në lidhje me situatën, me ç'rast gazetarit nga ai ekip do t'i dërgohen pyetje me interes për secilin medium, me pas ai ekip do t'i shpërndajë materialet e incizuara. Ose, servisi publik radiodifuziv këtë ua siguron sipas marrëveshjes.
- Nëse jeni dërguar në udhëtim në vende të një shteti ku ka numër të rritur të rasteve të regjistruara të sëmurë të „koronavirusit“ rreptësisht respektoni udhëzimet dhe udhëzimet e dhëna për parandalim.

REKOMANDIMET PËR RAPORTIM NGA TERRENI

- Kameramanët duhet të bëjnë dezinfektim të vazhdueshëm të pajisjes për punë me mjete të cilat do t'ua sigurojë menaxhmenti. Majat e stativave të prekin tokën nuk guxojnë të preken me duar të pambrojtura. Plotësisht, të dezinfektohen edhe pjesët ku stativat më shpesh kapen me duar, por edhe dorezat e torbës për mbajtje të pajisjes, si dhe pjesët e kamerës ku ajo preket me duar ose fytyrë. E njëjta këshillë ka të bëjë për secilën pajisje që

nevojitet për realizimin e incizimit, mes të cilave edhe kabllot të cilat më shpesh janë në tokë ose në sipërfaqe të dyshemesë.

- Fotoreporterët duhet të njëjtën ta bëjnë me pajisjen e tyre të punës.
- Dorëza e mikrofonit që përdoret në terren duhet të dezinfektohet njësoj sikur pajisja tjetër, por nëse mikrofoni ka sfungjer mbrojtës mbi të, ai duhet të trajtohet veçmas me dezinfektues spërkatës ose të mos përdoret kur nuk ka nevojë. Gjatë marrjes së deklaratave, mikrofonat të mbahen në distancën më të largët që lejojnë ata, e nëse ajo nuk është e mundur, atëherë të vendosen në anë të ndryshme për secilin bashkëbisedues, si dhe për gazetarin kur e përdor, gjatë së cilës assesi nuk guxojnë të preken me duar të cilat pastaj mund të prekin ndonjë pjesë të fytyrës, ose mikrofoni të prekë buzët e dikujt.
- Diktafonët dhe aparatet tjera për incizim të zërit, mes të cilëve edhe celularët të dezinfektohen para dhe pas vendosjes mbi sipërfaqe që janë publike dhe për të cilat nuk ka siguri se janë të dezinfektuara dhe të lejohet tjetërkush të vijë në kontakt me to gjatë incizimit, por edhe pas.
- Secili gazetar të përdorë kufjet e veta (nëse nuk i janë siguruar) për kyçje në link, për higjienën dhe dezinfektimin e të cilave vetë do të jetë përgjegjës.
- Gjatë incizimit dhe gjatë inkuadrimit të drejtpërdrejtë, nëse gazetarët kanë bashkëbisedues, atëherë distanca minimale mes secilit të pranishëm (gazetar – kameraman – bashkëbisedues) duhet të jetë një metër.
- Veturat zyrtare me të cilat shkohet në terren, të dezinfektohen para përdorimit, e posaçërisht dorezat hyrëse dhe dalëse të dyerve, timonët dhe ndërruesit e marsheve.

Nëse incizohet ose, vizitohet vend i cili llogaritet i rrezikshëm për infektim, siç është spitali ose klinika, vazhdimisht të mbahen dorashka mbrojtëse. Plotësisht, asnjëherë mos e lini pajisjen drejtpërdrejt në sipërfaqen e dyshemesë. Nëse ekziston mundësi vendosni një mbulojë të cilën pastaj do ta hidhni në një shportë të mbyllur për mbeturina, ndërsa pajisjen menjëherë fshijeni me faculeta alkoolike, duke e dezinfektuar tërësisht. Në këto lokacione, nëse është e mundur, kërkoni mbulesa mbrojtëse për këpucët për një përdorim ose mbani këpucë që rezistojnë ujin, dhe këto të jenë të lara para se të lëshohet vendi që është i rrezikshëm. Ndiqni rekomandimet e autoriteteve në situata të tilla.

- Çdoherë sigurohuni se duart tuaja janë krejtësisht të lara me ujë dhe sapun ose me dezinfektues me bazë të alkoolit para, gjatë dhe pas lëshimit të vendit të rrezikut.

- Organizata Botërore e Shëndetësisë u prononcua se nuk janë të nevojshme maskat mbrojtëse për personat që nuk kanë simptoma, vetëm nëse nuk është ndryshe e imponuar nga autoritetet. Posaçërisht në kushte kur incizoni në spital/klinikë ose rajon të prekur. Prapëseparë, nëse mbani maskë mbrojtëse, mbani maskë N95 ose maskë respiratorë FFP2/FFP3. Sigurohuni se maska e mbulon pjesën e fytyrës nga mbi hunda deri te pjesa e poshtme e mjekrës. Keni kujdes të mos hyjë ajri nga anash. Nëse keni mjekër ose mustaqe të cilat dalin nga kufijtë e maskës, ta dini se ajo nuk ju ndihmon, sepse nuk i mbyll hyrjet kryesore për thërmijat e viruseve. Shmangni prekjen e maskës. Kur do ta hiqni, thjesht kapeni vetëm për llastikë. Asnjëherë mos e prekni maskën, posaçërisht jo nga para.

REKOMANDIME PËR PUNË REDAKTUESE

- Mediat të marrin në konsideratë opsionin, nëse është e mundur në bazë të resurseve njerëzore në dispozicion, për t'i ndarë sektorët, redaksitë dhe departamentet teknike në dy ekipe që asnjëherë nuk do të krijojnë komunikim fizik ose privat me njëri-tjetrin gjatë një pandemie. Ky rekomandim është me interes të veçantë për servisin publik radiodifuziv, që edhe në skenarët më konservativ duhet të ketë ekipe në dispozicion për informimin e publikut. Me këtë rekomandim shmanget mundësia e infektimit të kolektivit në tërësi, ndërsa mbahen edhe kushtet optimale për punë.
- Një person duhet të kujdeset rreth komunikimit me kolegët që mungojnë për shkak të masave të Qeverisë së RMV, ose janë në vetizolim të domosdoshëm, për shkak të udhëtimit në ndonjë nga vendet me rrezik. I njëjti person, duhet ta informojë secilin të punësuar nëse ka ardhur në kontakt me person të infektuar ose person që ka udhëtuar në ndonjë nga vendet me rrezik, që t'i rekomandohet vetizolim të atij të punësuarit, në bazë të rekomandimeve nga MSH e RMV-së.
- Secili i punësuar i cili mund t'i kryejë obligimet e punës pa asnjë pengesë nga shtëpia e tij, të inkurajohet nga menaxhmenti ta bëjë këtë. Pa dallim nëse i takon ndonjë grupi me rrezik, ose ndonjë grupi që është pjesë e rekomandimeve të Qeverisë së RMV-së. Kështu, do të zvogëlohet frekuenca e njerëzve në hapësira të mbyllura, e me këtë edhe rreziku nga përhapja e virusit.
- Secili medium të ketë siguruar dezinfektues ose xhel me bazë të alkoolit në derën hyrëse ku edhe para daljes edhe gjatë kthimit prapa secili i punësuar ose mysafir duhet doemos t'i dezinfektojë duart tërësisht.
- Mjete të tilla të ketë në disa vende nëpër medium, për përdorim të vazhdueshëm dhe dezinfektim të vazhdueshëm të duarve në vendin e punës.

- Rekomandohet, nëse nuk është e domosdoshme, takimet e punës dhe kolegjiunet të mos mbahen, ose të mbahen në numër më të vogël të mundshëm ose nëpërmjet mënyrave alternative të komunikimit (video – konferencë, me telefon ose në hapësirë të hapur), ku mes çdo të pranishmi do të ketë distancë një metër.
- Rekomandohet nëpër korridore, në info – tabelat ose në vende të dukshme të vihen ilustrime për atë se si duhet të lahen duart sipas rregullave, si dhe informatat tjera të cilat menaxhmenti do të vlerësojë se janë të rëndësishme për t’u vendosur.
- Përcaktoni një hapësirë në të cilën do të konsumohet ushqim. Ushqim në hapësirat tjera dhe në vendet personale të të punësuarve nuk guxon të ketë, e aq më pak të ruhet.
- Gotat duhet të ruhen në hapësirë të mbyllur.
- Rekomandohet që ndarja fizike mes secilit të punësuar të jetë së paku një metër.
- Në hapësira të ketë shporta për mbeturina të cilat do të ishin me mundësi për mbyllje ose mbulim ose do të ishin në distancë të mjaftueshme nga të gjithë të punësuarit. Gjithashtu vlen edhe për shportat me kapacitet më të madh të mbeturinave.
- Nëse ndonjëri nga të punësuarit ka simptoma të ftohjes ose gripit, dhe janë të diagnostikuar se nuk janë në lidhje me „koronavirusin“ dhe përsëri vijnë në punë (që nuk preferohet), të rijnë në vendin e punës me maskë “kirurgjike” mbrojtëse (jo respiratore ose N95) në fytyrë, me çka do të parandalohej rënia e imunitetit kolektiv të të gjithë të punësuarve.
- Nëse dyshoni se në kolektivin e juaj ka person që shfaqë simptoma të „koronavirusit“, pa panik tregoni personit që është i përcaktuar për komunikim për COVID-19 ose drejtohuni të punësuarit, në distancë minimum një metër, të izohet në një hapësirë, ku askush nuk do të hyjë. Menjëherë kontaktoni shërbimet me epidemiologët.

- Nëse në kolektiv tani më fillon të përhapet COVID-19, secili që do të zhvillojë edhe simptoma më të lehta të ftohjes ose gripit, ose ka temperaturë të rritur (prej 37,3°C e më lartë) duhet të qëndrojë në shtëpi dhe të punojë nga shtëpia. Edhe ata që marrin paracetamol/acetaminofen, brufen/iboprufen ose aspirinë, gjithashtu, sepse këto ilaçe mund t'i fshehin simptomat e infeksionit.
- Hapësirat e përbashkëta të ajrosen vazhdimisht, ndërsa në hapësirat ku kjo bëhet me kondicionerë të ajrit dhe nuk kanë dritare (dhoma të shurdhëta, studio, dhoma-master, dhoma linku, regji...), kondicionerët e ajrit rregullisht mirëmbahen dhe pastrohen. Gjithashtu vlen edhe për kondicionerët e ajrit në hapësirat ku ka dritare.
- Të mos huazohen stilografë, USB, çakmakë, lapsa ose sende të imëta të përditshme, e për të cilat më parë nuk dihet në çfarë hapësirash kanë qëndruar
- Në kushte pandemie, secili i punësuar kujdeset për higjienën e hapësirave të përbashkëta.
 - Dorezat e dyerve rregullisht të fshihen me dezinfektues alkoolik.
 - Në tualet vazhdimisht të ketë sapun, ujë, letër higjienike dhe fshirës për duar.
 - Në hapësirat e kuzhinës të ketë sapun, ujë dhe fshirës për duar, si dhe detergjent të lëngshëm për larje të enëve dhe gotave. Enët dhe gotat të mbahen në vende të mbyllura.
 - Te vendet për make up të sigurohen sfungjerë për vendosjen e pudrës për secilin veç e veç, ndërsa mysafirëve t'u rekomandohet të mbajnë mjetet e veta për vendosje të make up-it. Nëse ekziston mundësi të mundësohet ujë i ngrohtë dhe sapun në vendet e make up-it për higjienë të vazhdueshme, për shkak të prekjës së fytyrës.

- Sipërfaqet punuese (tavolinat, tastierat, mausat, dorëzat e karrigeve) rregullisht të dezinfektohen me mjete me bazë të alkoolit.
- Teknika që shfrytëzohet vazhdimisht në regji dhe në hapësirat tjera, siç janë kabinat e shurdhëta off-tone ose printerët e përbashkët të dezinfektohen me sistem për spërkatje.
- Mikrofonat në kabinat off-tone dhe në studio të jenë në distancë më të madhe nga standardet dhe nëse ekziston mundësi gazetarët, udhëheqësit e mysafirëve në studio të mos flasin drejtpërdrejt në ta. Sfungjerët mbi mikrofonta të dezinfektohen më minimum 60 për qind dezinfektues alkoolik me sistem spërkatjeje.
- Sipërfaqet e pulteve të studiove, tavolinat dhe llojet tjera të mobileve gjithashtu të dezinfektohen vazhdimisht.
- Montazherët të mbajnë dezinfektim të rregullt të sipërfaqeve punuese, tastierave dhe mausëve për punë, dhe nëse nuk është e domosdoshme të mos shfrytëzohen kufje për audio montazh, por altoparlantë. Nëse shfrytëzojnë kufje, të fshihen me dezinfektues. Gjithashtu vlen për të gjithë punonjësit e medimeve, mes të cilëve edhe interpretuesit e gjuhës së shenjave, e të cilët janë të ekspozuar në punë në kompjuter dhe/ose me kufje, gjegjësisht lloj tjetër të pajisjes për punë.
- Kameramanët të kujdesen për higjienën e pajisjes së studios për incizim dhe transmetim dhe dezinfektimin e saj.

PJESËMARRJA E PERSONAVE NGA JASHTË NË EMISIONE

- Udhëheqësit e emisioneve ku organizohet ardhja e mysafirëve nga jashtë, mund t'i organizojnë pjesëmarrje online nëpërmjet skajp-it (skype) zum (www.zoom.us) ose platforma tjera të ngjashme, gjatë së cilës edhe personat që janë vetizoluar, e që janë me interes publik mund të vazhdojnë të jenë pjesë e emisioneve debatuese. Kjo posaçërisht do të jetë e nevojshme kur pandemia do të jetë në kulm, ndërsa masat do të jenë jashtëzakonisht restriktive për popullatën, si dhe për shkak të paraqitjes së shqetësimit të përgjithshëm gjatë daljes nga shtëpia.

- Nëse, përsëri, ka mysafirë, të cilët do të jenë në studio, t'i pyesin a kanë udhëtuar gjatë 14 ditëve të kaluara në ndonjë nga vendet me rrezik, e nëse jo, a kanë pasur kontakte me persona të cilët gjatë 14 ditëve të kaluara kanë udhëtuar në ndonjë nga vendet me rrezik. Me këtë, do të zvogëlohet mundësia për përhapjen e „koronavirusit“ në vendin e punës, e me këtë mbrohet edhe gjithë media nga izolimi, nëse ndodh paraqitja e rastit të regjistruar në kolektiv.

- Mysafirët të inkurajohen të vijnë me veturën e vet ose me taksi, në vend të transportit të siguar zyrtar nga ana e medias .

- Mysafirët doemos t'i dezinfektojnë duart gjatë hyrjes në ambientet e medias.

- Gjatë shërbimeve për rregullimin e flokëve dhe make up-it për mysafirët, para dhe pas kësaj doemos të dezinfektohet pajisja e përdorur për këtë.

SIGURIA ONLINE GJATË KOHËS KRIZËS

- Kushtoni kujdes sigurisë suaj digjitale. Keni parasysh se në bazë të të dhënave nga kompania për sajber-siguri, „Norton“, organizatat ndërkom-bëtare gazetareske kanë paraqitur mashtrues dhe hakerë të cilët dërgojnë porosi elektronike – spam lidhur më COVID-19 (koronavirusin) me mundësi për vjedhje të të dhënave personale. Nëse ju ndodh një gjë e tillë, paraqitëni në Sektorin për kriminalitet kompjuterik dhe forenzikë digjitale pranë MPB të RMV-së.


KËSHILLA PËR MARRËDHËNIEN E PUNËS

Nëse u është mohuar e drejta, që u takon nga vendimet dhe rekomandimet që i ka sjellë Qeveria e RMV-së në lidhje me lirim tuaj nga puna gjatë pandemisë me COVID-19 dhe/ose u është bërë mobing nëpërmjet burimeve tjera të rrezikimit të shëndetit tuaj dhe/ose shëndetit të kolegëve tuaj, drejtohuni deri te Inspektorati Shtetëror i Punës në numrin e telefonit 151-31 pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) ose deri te Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM). Kjo vlen edhe për të punësuarit të cilët në bazë të sugjerimeve dhe rekomandimeve konkrete nga Qeveria e RMV-së janë të liruar nga obligimet e punës në një periudhë të caktuar si prindër të fëmijëve deri në një moshë të caktuar.

Kujdes për punëdhënësit nga sektori shtetëror dhe privat në këtë pjesë kërkoi edhe Qeveria e RMV-se, duke theksuar se mosrespektimi do të sanksionohet, në pajtim me nenet 205 dhe 206 të Kodit Penal (KP) për rrezik nga përhapja e sëmundjeve ngjitëse.

BURIMET E SHFRYTËZUARA PËR PJESËN B:

- Coronavirus disease (COVID-19) outbreak. WHO; 2020. Qasje në: <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019> - për herë të fundit qasur më 16.3.2020
- Getting your workplace ready for COVID-19. WHO; 27 February 2020. Qasje në: <https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/getting-workplace-ready-for-covid-19.pdf> - qasur më 12.3.2020
- CPJ Safety Advisory: Covering the coronavirus outbreak. CPJ; March 9, 2020. Qasje në: <https://cpj.org/2020/02/cpj-safety-advisory-covering-the-coronavirus-outbr.php> - qasur më 10.3.2020.
- CPJ Journalist Security Guide: Covering the News in a Dangerous and Changing World. Frank Smyth/CPJ Senior Adviser for Journalist Security, with updates from CPJ's Emergencies Response Team; 2020. Qasje në: <https://cpj.org/reports/2012/04/journalist-security-guide.php> - qasur më 11.3.2020
- Protection measures for persons who are in or have recently visited (past 14 days) areas where COVID-19 is spreading. WHO; 2020. Qasje në: <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/advice-for-public> - qasur më 12.3.2020.
- Korona-COVID-19 Broshura. Shoqata Maqedonase për Mbrojtje gjatë Punës (SHMPP); mars, 2020. Qasje në: <http://mzzpr.org.mk/wp-content/uploads/2020/03/Korona-Covid-19-бpowyupa.pdf> – për herë të fundit qasur më 16.3.2020
- Të gjitha informatat, rekomandimet, pyetjet, përgjigjet dhe të vërtetat për koronavirusin. Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut; mars, 2020, 2020. Qasje në: <http://zdravstvo.gov.mk/korona-virus/> - për herë të fundit qasur më 16.3.2020
- Safety WP, World Health Organization. WHO guidelines on hand hygiene in health care. World Health Organization; 2009. Qasje në: <https://www.who.int/gpsc/5may/tools/9789241597906/en/> - qasur më 15.3.2020
- WHO Standard Precaution. World Health Organization; 2007. Qasje në: https://www.who.int/csr/resources/publications/EPR_AM2_E7.pdf - qasur më 15.3.2020
- N95 vs FFP3 & FFP2 masks – what's the difference? Достапно на: <https://fastlife hacks.com/n95-vs-ffp/> - qasur më 15.03.2020
- Novel Coronavirus (COVID-19) v3. WHO Operational Support; 2020. Qasje në: www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/dcp-ncov.pdf?sfvrsn=f5fe6234_4&download=true - qasur më 10.3.2020
- Tragedies & Journalists. by Joe Hight, Frank Smyth; February 17, 2009. Qasje në: <https://dart-center.org/content/tragedies-journalists-6?section=all> – qasur më 14.3.2020



www.znm.org.mk